

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR "NOBI" shpk,

Në Tiranë, sot më datë 28.09.2023, ne tëposhtëshënuarit;

Panajot Duli, i datëlindjes 07.07.1995, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,J507070410.

Dritjon Selmani, i datëlindjes 14.02.1995, lindur ne Puke dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,J50214034F.

Besim Gura i datëlindjes 15.07.1995, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,J50715070V.

Me cilësinë e "ortakeve themelues" deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 " Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "NOBI" shpk.

Neni 1.

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin "NOBI" shpk, dhe formë ligjore: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" e quajtur më poshtë "Shoqëria".

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria "NOBI" shpk e ka selinë në adresë: Rruga Haxhi Dalliu Nr 7, Zona kadastrale 8350, Volumi 20, faqe 213, Tiranë dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë "NOBI" shpk është: Agjensi e turizmit mjekësor, ndermjetësim të pacientëve me klinikat që ofrojnë shërbimin, organizim i guidave turistike brenda dhe jashtë vendit, promovim dhe organizim i turizmit dentar, shërbime telefonike, telemarketing dhe marketing.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000lekë, i ndarë në 3(tre) kuota të cilat zotërohet si më poshtë:

Panajot Duli, i datëlindjes 07.07.1995, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti me numër personal ,J50707041O zotëron një kuotë ose 33,33 % të shoqërisë.

Dritjon Selmani,i datëlindjes 14.02.1995, lindur ne Puke dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti me numër personal ,J50214034F,zotëron një kuotë ose 33,33 % të shoqërisë.

Besim Gura i datëlindjes 15.07.1995, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti me numër personal ,J50715070V,zotëron një kuotë ose 33,34 % të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;



ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.



Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë "NOBI" shpk është: Dritjon Selmani, i datëlindjes 14.02.1995, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti me numër personal, J50214034F.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 28.09.2023.


Afati i emërimit të administratorit është deri me 28.09.2028.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11



Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakut themelues të shoqërisë tregtare **"Nobi" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.


ORTAKET THEMELUES

Panajot Duli

Dritjon Selmani

Besim Gura

Panajot Duli
Dritjon Selmani
Besim Gura



Tiranë, më datë 28.09.2023